



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 88-të, të mbajtur më 16.06.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-8855/1 të datës 20.10.2022 me pretendime kundër personit juridik privat -
-----HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka kompetencë të veprjë për shkak se pretendimet në rastin i referohen çështjeve që nuk janë objekt i veprimit të saj kompetent dhe për të cilat një organ tjetër është kompetent për të vepruar.

Lënda me numër 12-8855/1 të datës 20.10.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së- brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më datë 20.10.2022, në adresën elektronike të KSHPK-së është dorëzuar një kërkesë nga një parashtrues i njohur, sipas të cilit është formuar lënda nr. -----

----- Shkup, për pakujdesi dhe menaxhim jo të mirë të llogarisë së bashkësisë së pronarëve të banesave dhe veprimet e tij në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për banim. Në rastin konkret, bëhet fjalë për pakënaqësi të parashtruesit si pronar i një pjese të veçantë – banesë në një objekt banesor në Shkup, pasi nga pakujdesia e menaxherit, qiramarrësit janë shkëputur nga sistemi i ngrohjes dhe ujit të ngrohtë. për tre ditë.

Gjatë shqyrtimit të raportit në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se në rastin konkret bëhet fjalë për pretendime për çështje që nuk janë objekt i veprimit të saj kompetent dhe për të cilat është kompetent për të vepruar një autoritet tjetër. Nga aty KSHPK-ja konsideroi se nuk ka kompetencë të veprjë për këtë çështje dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar**

Katica Nikolovska

Dorëzuar:

- Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: J.C.

Miratoi: G.T, anëtar i KSHPK-së

